



# KOMISIONI RREGULLATOR I ENERGETIKËS DHE I SHËRBIMEVE TË UJIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



## NJOFTIM PËR OPINIONIN

**Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit (KRRE) njofton opinionin se nuk kryen miratimin e vendimit për tarifën përfundimtare të çmimit të ujit, por e përcakton tarifën mesatare maksimale dhe minimale, në suaza të së cilës këshilli komunal i komunës, me propozim të ndërmarrjeve komunale, sjell vendimin për shumën e tarifës për qytetarët.**

Përcaktimi i tarifës së çmimit të ujit përfshin disa faza: KRRE-ja iu propozon ndërmarrjeve komunale tarifën mesatare minimale dhe maksimale të çmimit të ujit, sipas së cilës secila NPK formon tarifa, të cilat do t'i paguajnë kategoritë e ndryshme të konsumatorëve, të cilat i dërgon për miratim te këshilli komunal, i cili sjell vendimin përfundimtar për tarifën e ujit. Të gjitha komunat, të cilat kanë mbi 10.000 banorë, marrin propozime trivjeçare për çmimin e ujit të pijshëm nga KRRE-ja. Me kufirin e përcaktuar për tre vitet e ardhshme, **Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit, iu ka mundur ndërmarrjeve që gjatë përcaktimit të çmimeve përfundimtare, t'i ruajnë çmimet ekzistuese, të cilat i arkëtojnë në vitin 2020, ndërsa ndërmarrja komunale më pas vendos nëse do të dërgojë apo jo propozim deri te komuna për rritjen e çmimit.**

KRRE-ja për momentin ka kompetenca të kufizuara sa i përket tarifës përfundimtare të çmimit të ujit të pijshëm. Sipas mundësive ligjore, KRRE-ja vetëm propozon tarifë mesatare minimale dhe maksimale për tre vite, pastaj Ndërmarrjet Publike Komunale zgjedhin nëse do ta pranojnë njërin nga tarifat apo nuk do të pranojnë asnjë propozim. Tarifa minimale mundëson funksionim elementar të ndërmarrjes publike komunale pa asnjë investim, ndërsa në formimin e tarifave të tjera janë përllogaritur edhe investimet e domosdoshme për vitin e ardhshëm. Gjatë viteve të kaluara kemi qenë dëshmitarë se komunat më së shpeshti përcaktohen për tarifë mesatare minimale, e cila nuk mundëson investime dhe për këtë po ballafaqohemi me defekte të rritjes të ujësjellësit. Për këtë, KRRE-ja kërkon që ta ndërmarrë plotësisht autorizimin për formimin e tarifës së ujit," deklaroi Marko Bislimoski, kryetar i Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit.

**Sa i përket vendimit për tarifën mesatare të komunës së Shtipit, ju informojmë se me përcaktimin e tarifës minimale, KRRE-ja i ka mundur NPK "Isar" që ta ruajë çmimin e njëjtë sikurse në vitin 2020.**

"Në vendimin tonë çmimi maksimal është më i ulët se çmimi, të cilin e kanë kërkuar nga NPK "Isar". Për amvisëritë NPK "Isar" kanë kërkuar 46,48 denarë, ndërsa minimalja sipas nesh mund të jetë e njëjtë me atë aktualen, ndërsa maksimalja 46,39 denarë. JKP "Isar" kanë kërkuar edhe rritje të çmimit të ujërave të zeza, por Komisioni Rregullator i Energjetikës ka propozuar që të ulet," theksoi Bislimoski.

13.01.2021



rr. Makedonija nr. 25, pallata L Lazar Pop-Trajkov, kati i 6 • 1000 Shkup,  
Republika e Maqedonisë së Veriut

Qendra 02 3233-580 • Faksi: 02 2556 004 • [www.erc.org.mk](http://www.erc.org.mk) • e-mail: [erc@erc.org.mk](mailto:erc@erc.org.mk)